



KALLZIM PENAL

- KALLËZUES:** Partia Demokratike e Shqipërisë, subjekt i së drejtës regjistruar me vendimin 12 datë 19/12/1990 të Ministrit të Drejtësisë, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm Enkelejd Alibeaj, me adresë Rruga Donika Kastrioti, Tiranë.
- OBJEKTI:** Kallëzim i veprës penale të “Shpërdorim i detyrës” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.
- KUNDËR:** Lindita Nikolla, e bija e Llesh-it dhe Rute-s, lindur më 22.10.1965, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me kartën e identitetit me numër personal G56022058H, me detyrë Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe adresë për efekt njoftimi Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 75/a, 280, 283 e vijues të K.Pr.Penale,
Neni 248 dhe 25 të Kodit Penal,
Nenet 8, 9, 10 e vijues të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”,
Ligji 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike”,
Nenet 1, 7, 15 e vijues të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin numër 166, datë 16.12.2004 të Kuvendit
- DREJTUAR:** **PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT - SPAK.**

I nderuar Z. Drejtues,

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju parashtrojmë këtë kallëzim penal për veprën “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e cila vlerësojmë se është konsumuar nga shtetasja Lindita Nikolla në ushtrim të funksionit të saj si Kryetare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Më poshtë në këtë kallëzim kemi parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore penale të cënuara, si dhe analizën juridike e provat me anë të të cilave vërtetohet konsumimi i veprës penale.

RRETHANAT E FAKTIT

1. Më datë 02.09.2023, Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike miratoi ndryshimet statutore, të cilat referuar statutit të miratuar (neni 62, pika 1) hynë në fuqi më datë 03.09.2023. Neni 48, pika 3, i Statutit parashikon njehsimin e pozicionit të Kryetarit të Partisë me pozicionin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të saj në rastet kur Partia Demokratike nuk është shumicë qeverisëse. Gjithashtu neni 48, pika 5, përcakton të drejtën e Kryesisë së Partisë për miratimin e rregullores së brendshme të Grupit Parlamentar. Në përputhje me nenin 48 pika 5, Kryesia e Partisë Demokratike, me vendimin numër 24, datë 03.09.2023, protokolluar me numër 137 prot, ka miratuar “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe veprimtarinë e deputetëve të tij”.
2. Më datë 04.09.2024 Kryetari i Partisë Demokratike dhe njëkohësisht edhe Kryetari i Grupit Parlamentar, me shkresën numër 138 prot, drejtuar shtetases Lindita Nikolla, në cilësinë e Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e nenit 16, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, njofton institucionin e Kuvendit për ndryshimet në kryesimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
3. Në seancën plenare të datës 4 nëntor, shtetasja Lindita Nikolla ka deklaruar se: “Gjithashtu, ju bëj me dije se sot në orën 09:00 kam marrë njoftimin nga Partia Demokratike e Shqipërisë, e cila më vë në dijeni se, në zbatim të nenit 16, pika 2 e Rregullores së Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 6 të rregullores së Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, miratuar me vendimin nr. 24, datë 3 shtator 2023, të kryesisë së PD-së, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike është kryetari i Partisë Demokratike, zoti Lulzim Basha”. Në përputhje me rregulloren e Kuvendit dhe praktikën Parlamentare, me njoftimin e Kryetares së Kuvendit dhe njoftimin e mëposhëm të seancës plenare nga Kryetarja e Kuvendit konsiderohet e shteruar rruga administrative dhe funksionet e Kryetarit të Grupit Parlamentar mund të ushtrohen vetëm nga Z.Lulzim Basha.
4. Më datë 13.09.2023, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, përfaqësuar nga Kryetari Lulzim Basha, me shkresën nr.148 prot datë 13.09.2023, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Kryetares së Kuvendit shtetases Lindita Nikolla, në mbështetje të nenit 16 pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të nenit 48 të Statutit të PDSH-së, miratuar me Vendimin nr.1 datë 02.09.2023 të Kuvendit Kombëtar të PDSH-së, Neni 5 pika 3 dhe neni 6 të Rregullores të GPPD miratuar me Vendimin nr. 24 datë 03.09.2023 të Kryesisë së PDSH-së si dhe Vendimit nr. 25 datë 13.09.2025 të Kryesisë së PDSH-së, njofton institucionin e Kuvendit për përbërjen e Kryesisë së Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike si më poshtë vijon: a-Lulzim Basha- Kryetar, b-Flutura Aça- Nënkryetare, e autorizuar për përfaqësimin e Grupit Parlamentar në mungesë të Kryetarit të Grupit, c-Kreshnik Çollaku-Nënkryetar, d- Arbi Agalliu-Sekretar, Oriola Pumpuri- Zëdhënëse.
5. Më datë 15.09.2023 Partia Demokratike është njohur me shkresën nr. 2583/5 datë 13.09.2023 me objekt: “Për lirimin nga detyra të Z.Rezart Kthupi”. Në brendi të kësaj shkrese relatohet se: “Në zbatim të vendimit nr. 15 datë 13.09.2023 të Kryetares së Kuvendit Znj. Lindita Nikolla, Z.Rezart Kthupi lirohet nga detyra e Këshilltarit Të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike”. Kjo shkresë e nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm Legjislativ Merita Qato referon faktin e ekzistencës së vendimit nr.15 datë 13.09.2023 me të cilin Kryetarja e Kuvendit ka zgjidhur marrëdhëniet e punës, të cilat lidhen dhe zgjidhen me kërkesë të Grupit Parlamentar

me shtetasin Rezart Kthupi i cili në bazë të rregullores së Kuvendit gëzonte cilësinë e Këshilltarit.

6. Me datë 18.09.2023 Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike me shkresën numër 155 prot drejtuar Kryetares së Kuvendit, njofton Kuvendin për dorëzimin e detyrës nëpërmjet dorëheqjes, të sekretares së grupit parlamentar, dhe emërimin në detyrë të sekretares së re. Kjo kërkesë në dijeninë e kallëzuesit është realizuar vetëm pjesërisht duke bërë vetëm ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me shtetasen Dorilda Kaçuli, por pa lidhur marrëdhënie të reja të punës me shtetasen Iriša Çupa.
7. Më datë 26.09.2023 me shkresën nr. 164 prot me titull “Mbi Përbërjen e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike” është njoftuar Kryetarja e Kuvendit mbi përbërjen e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, përbërje e kufizuar në 24 deputetë në total.
8. Më datë 03.10.2023 Partia Demokratike është njohur me shkresën 2583/12 datë 03.10.2023 me objekt: “Për lirim nga detyra të Znj.Marinelë Ziu”. Në brendi të kësaj shkrese relatohet se: “Në zbatim të vendimit nr. 16 datë 13.09.2023 të Kryetares së Kuvendit Znj. Lindita Nikolla, Znj.Marinelë Ziu lirohet nga detyra e Këshilltarit Të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike”. Kjo shkresë e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm Genci Gjonçaj referon faktin e ekzistencës së vendimit nr.16 datë 13.09.2023 me të cilin Kryetarja e Kuvendit ka zgjidhur marrëdhëniet e punës, të cilat lidhen dhe zgjidhen me kërkesë të Grupit Parlamentar me shtetasen Marinela Ziu e cila në bazë të rregullores së Kuvendit gëzonte cilësinë e Këshilltarit. Në rastin e kësaj shkrese njoftohet se marrëdhëniet financiare ndërpriten në datë 03.10.2023, 20 ditë më vonë se data e urdhrin/ vendimit ndërkohë që Znj.Ziu ishte në kushtet e raportit për leje barrëlindje.
9. Më datë 04.10.2023 është mbajtur mbledhja e Konferencës së Kryetarëve, në përfundim të së cilës është hartuar procesverbali përkatës i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit. Në këtë procesverbal rezulton se Z. Bardhi merr pjesë në Konferencën e Kryetarëve në cilësinë e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, cilësi e cila mbartet gjatë gjithë mbledhjes ku evidentohen fjalë të ndryshme të shtetasit Bardhi.
10. Më datë 10.10.2023 me shkresën nr.177 prot me titull “Mbi Përbërjen e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike”, Kryetari i Partisë Demokratike Z. Lulzim Basha njëkohësisht edhe Kryetar i Grupit Parlamentar të saj njofton Znj.Nikolla për përfundimin e anëtarësisë së deputetit Gazmend Bardhi në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike.
11. Më datë 11.10.2023, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, përfaqësuar nga Kryetari Lulzim Basha, me shkresën nr.178 prot datë 11.10.2023, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Kryetares së Kuvendit shtetasës Lindita Nikolla, në mbështetje të nenit 16 pika 3 të Rregullores së Brendshme të Kuvendit, miratuar me vendimin nr.166 datë 16.12.2004 ka përcjellë disa ndryshime në vendet dhe uljen për disa nga deputetët anëtar të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike si më poshtë vijon: - Z. Arbi Agalliu zë vendin e z.Gazmend Bardhi dhe anasjelltas, -Z. Kreshnik Çollaku zë vendin e z.Agron Gjekmarkaj dhe anasjelltas. Në koordinim me deputetë të tjerë ndryshimin e vendve si më poshtë: - Z.Selaudin Jakupllari zë vendin e z.Lefter Gështhenja dhe anasjelltas, - Znj.Andia Ulliri zë vendin e z.Asllan Dogjani dhe anasjelltas,- Znj.Merita Bakiu zë vendin e z.Saimir Korreshi dhe anasjelltas.

12. Më datë 12.10.2023 është mbajtur seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë seancë plenare në përputhje me nenin 16 pika 2 të Rregullores së Kuvendit Kryetarja e Kuvendit, shtetasja Lindita Nikolla ka njoftuar Kuvendin për shkresën nr.164 prot datë 26.09.2023 dhe shkresën nr. 177 prot datë 10.10.2023 (të cituara më lart) mbi përbërjen e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Me këto dy shkresa dhe me njoftimin e tyre ndaj Kuvendit mbyllet zyrtarisht procedura për njoftimin dhe njohjen si nga Kryetarja e Kuvendit ashtu dhe nga Kuvendi të përbërjes së Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, duke njohur zyrtarisht dhe mosqënien më të deputetit Gazmend Bardhi pjesë e Grupit Parlamentar.
13. Më datë 12.10.2023, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, me shkresën përkatësisht nr. 179 prot dhe nr. 180 prot, i është drejtuar Kuvendit dhe Kryetares së Kuvendit Znj.Lindita Nikolla, në mbështetje të Rregullores së Kuvendit miratuar me vendimin nr.166, datë 16.12.2004, e ndryshuar, për të bërë emërimet si më poshtë vijon: -Znj.Marinel Ziu emërohet Këshilltare në Komisionin e Përhershëm “Për veprimtaritë Prodhuese, Tregëtinë dhe Mjedisin., -Z. Rezart Kthupi emërohet Këshilltar në Komisionin e Përhershëm “Për Çështjet ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut”.
14. Më datë 27.10.2023, Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Z.Lulzim Basha, ka depozituar kërkesë me titull” Për pasqyrimin e ndryshimeve” drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me nr. 186 prot për të bërë pasqyrimet e njoftuara në faqen zyrtare online të Kuvendit që kishin për objekt ndryshimin e përbërjes së Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, të lexuara në seancën e datës 12/10/2023 nga Kryetarja e Kuvendit Znj.Lindita Nikolla si dhe shpërndarjen e vendeve për uljen e deputetëve në sallën e Kuvendit.
15. Më datë 16.11.2023, Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Z. Lulzim Basha, mbështetur në nenin 77 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 24 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, pikën III të vendimit numër 12, datë 10.02.2022 “Për Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Realizimin e Reformës Zgjedhore” i ka drejtuar Kryetares së Kuvendit, Znj. Lindita Nikolla, kërkesën me titull “Për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore”, për zëvendësimin e Znj.Grida Duma marrë shkas nga fakti që kjo shtetase gëzon cilësinë e anëtares së Komisionit por nuk gëzon cilësinë e deputetes dhe zëvendësimin e saj me deputeten Oriola Pampuri.
16. Nga analiza e akteve të prodhuara në Konferencën e Kryetarëve (si një nga organet më të larta të funksionimit të Kuvendit) rezulton se në të gjitha mbledhjet duke filluar nga data 20.09.2023 e deri më datë 03.03.2024 është thirrur, (ka marrë pjesë ose ka munguar) në cilësinë e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike deputeti Gazment Bardhi. Ky i fundit është thirrur dhe ka marrë pjesë aktive në mbledhjet e datave 20.09.2023; 29.09.2023; 04.10.2023; 11.10.2023 dhe 03.03.2024 si dhe është thirrur dhe nuk ka marrë pjesë në mbledhjet e datave 01.11.2023; 23.11.2023; 11.01.2024, 24.01.2024 dhe 24.02.2024.
17. Më datë 03.04.2024 Partia Demokratike është njohur me shkresën nr. 3242/3 datë 03.04.2024 me objekt: ”Për lirin nga detyra të Z. Ndriçim Mehmeti”. Në brendi të kësaj shkrese relatohet se: “Në zbatim të vendimit nr. 09 datë 03.04.2024 të Kryetares së Kuvendit Znj. Lindita Nikolla, Z. Ndriçim Mehmeti lirohet nga detyra e Këshilltarit Të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike”. Kjo shkresë e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm Genci Gjonçaj referon faktin e ekzistencës së vendimit nr. 09 datë 03.04.2024 me të cilin Kryetarja e Kuvendit ka zgjidhur marrëdhëniet e punës, të cilat lidhen dhe zgjidhen me kërkesë të Grupit Parlamentar me shtetasin Ndriçim Mehmeti i cili në bazë të rregullores së Kuvendit gëzonte cilësinë e Këshilltarit.

18. Më datë 10.04.2024 jemi njohur nëpërmjet komunikimeve mediatike publike për kërkesën e deputetit Gazment Bardhi, drejtuar Kryetares së Kuvendit Lindita Nikolla me objekt revokimin e të gjitha masave për përjashtimin nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të deputetëve të ndryshëm. Kjo kërkesë drejtuar Kryetares së Kuvendit përbën një qëndrim i cili është në kundërshtim me vendimmarrjet politike të organeve të drejtuese të Partisë Demokratike dhe është një cënim i drejtpërdrejtë i vullnetit politik të këtij subjekti. Në më shumë se një rast Partia Demokratike me anë të vendimeve të organeve drejtuese të saj, Kryetari, Kryesia dhe Këshilli Kombëtar ka vendosur për përjashtimin e deputetëve të ndryshëm nga Grupi Parlamentar, qëndrime dhe sanksione të cilat janë reflektuar pjesërisht edhe nga Kuvendi i Shqipërisë.

ARSYETIMI LIGJOR

19. Duke respektuar të drejtën ligjore të organit të akuzës për cilësimin e saktë ligjor të veprës penale vlerësojmë se në objekt kallzimi janë konsumuar plotësisht elementët e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, i kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

SHPËRDORIMI I DETYRËS

20. Shpërdorimi i detyrës si vepër penale parashikohet nga neni 248 i Kodit Penal i cili përcakton se: *“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet”*.

21. Duke analizuar katër elementët klasikë të veprës penale, në dritën e parashikimeve të nenit 248 të Kodit Penal rezulton se që të jemi në kushtet e konsumimit të veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të katër kushtet e mëposhtme:

- **objekti i veprës penale** kërkon që të vërtetohet thyerja e rregullave të vendosura nga aktet ligjore ose nënligjore, që normojnë detyrat e nëpunësit shtetëror apo publik.
- **nga ana objektive** e pandehura me veprime aktive, ose mosveprime të kundraligjshme duhet të ketë sjellë pasoja në dëm të shtetit ose të shtetasve, apo përfitime të padrejta, materiale ose jo materiale për vete apo për persona të tretë. Gjithashtu, si në çdo vepër penale për të marrë në përgjegjësi personin e dyshuar për këtë vepër, duhet patjetër të ekzistojë lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë mes veprimit apo mosveprimit të të pandehurit dhe ardhjes së pasojës kriminale që në këtë rast mund të jetë: 1- dëm ndaj subjekteve të ndryshëm fizikë dhe juridikë apo/dhe shtetit; 2- përfitime materiale apo jomateriale të padrejta për vete apo, për të tretë.
- **subjekti i veprës penale** duhet të jetë i posaçëm: të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, pra të jetë mbi 14 vjeç dhe mbi të gjitha duhet të ketë attribute për të ushtruar shërbimin publik apo detyrën shtetërore përkatëse.
- **nga ana subjektive**- kjo vepër kryhet me dashje, me qëllim përfitimi material ose jo material, të padrejtë për vete apo, për persona të tjerë apo me qëllim për të shkaktuar dëme tek subjektet fizikë, juridikë apo shtetit.

22. Në raport me objektin e veprës penale rezulton se Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin numër nr. 166, datë 16.12.2004, ndryshuar me vendimin nr. 15, datë 27.12.2005, vendimin nr. 193, datë 7.7.2008, vendimin nr. 21, datë 04.03.2010, vendimin nr. 41, datë 24.6.2010, vendimin nr. 88, datë 24.2.2011, vendimin nr. 41 datë 30.05.2013, vendimin nr. 95 datë 27.11.2014, vendimin nr. 88 datë 14.9.2017, vendimin nr. 85 datë 18.7.2019, vendimin nr. 12/2020, vendimin nr. 86/2021 dhe vendimin nr. 126/2023, ka miratuar Rregulloren e Kuvendit. Kjo rregullore në nenin a/1, pika1, parashikon fushën e zbatimit të saj duke përcaktuar se: *“1. Kjo Rregullore përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në vijim Kuvendi, për organet drejtuese, mbledhjet e komisioneve dhe seancave plenare, procedurën ligjvënëse, kontrollin parlamentar, monitorimin e procesit për integrimin europian, zgjedhjen/ emërimin/ shkarkimin e organeve kushtetuese dhe të institucioneve të krijuara me ligj, interpretimin dhe ndryshimin e Rregullores, imunitetin parlamentar, transparencën dhe shërbimet e Kuvendit”*. Nisur nga fusha e zbatimit të Rregullores, në nenin 7 të saj është përcaktuar edhe funksioni dhe detyrat e Kryetarit të Kuvendit. Në mënyrë të përmbledhur neni 7 i Rregullores përcakton se: *“1. Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Ai kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare, në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme Kuvendit dhe strukturave të tij... 6. Në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të tij, Kryetari i Kuvendit nxjerr urdhra dhe udhëzime.”* Nisur nga sa përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit rezulton se ky akt rregullues, i parashikuar nga Kushtetuta në nenin 75/2 të saj, është akti i cili në kuptim të objektit të veprës penale mbrohet posaçësisht nga ligji penal dhe që formëson dhe normon detyrat e nëpunësit publik apo ushtruesit të detyrës shtetërore.
23. Përpara se të analizojmë anën objektive të veprës penale e gjykojmë të nevojshme të bëjmë një analizë të raportit të varësisë ndërmjet grupit parlamentar dhe partisë politike që e përfaqëson atë.
24. Sistemi politik në Shqipëri është i bazuar mbi krjimin dhe funksionimin e partive politike, të cilat kur janë parti parlamentare ndërtojnë ndër të tjera edhe infrastrukturën e zgjedhjeve politike në vend. Sistemi zgjedhor në Shqipëri është sistemi zgjedhor proporcional në të cilin deputetët zgjidhen në masën dërmuese të tyre sipas listave të hartuara, miratuara dhe paraqitura në zgjedhje nga Partitë Politike. Deputeti zgjidhet kryesisht për shkak të përkatësisë së tij në një nga partitë politike, e cila i fiton votat në bazë të një programi elektorale të paraqitur përpara zgjedhësve. Ky parim i përgjithshëm reflektohet edhe në mbrojtjen që Rregullorja e Kuvendit i njeh partive politike në raport me deputetin. Nga leximi sistematik i Rregullores së Kuvendit rezulton se grupet parlamentare a) *“...formohen mbi bazën e listës së partive politike që përfaqësohen në Kuvend, bazuar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, të shpallur me vendim të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.”* (pika 2 e nenit 15) dhe b) *“...mund të formohen menjëherë pas konstituimit të Kuvendit ose gjatë legjislaturës, nga deputetë të pavarur, nga deputetë që largohen nga partia politike për të cilën kanë konkurruar në zgjedhje, nga deputetë që janë deklaruar jashtë grupeve ose kur krijohet një subjekt politik i ri”* (pika 3 e nenit 15). Diferenca në formulimin e dy dispozitave të njëpasnjëshme është përdorimi në rastin e dytë të togfjalëshit “mund të formohen”, në rastin e grupeve të formuara mbi bazën e orientimit politik, në raport me fjalën “formohen”, të përdorur në rastin e grupeve të formuara mbi bazën e partive politike. Ky formulim tregon jo vetëm që si rregull grupet parlamentare formohen mbi bazën e përkatësisë partiake të deputetëve, por edhe (lexuar edhe në sintezë me të gjithë korpusin ligjor të ndërtimit të sistemit politik dhe parlamentar) që jeta parlamentare bazohet mbi partitë politike dhe se grupet parlamentare janë vetëm organe përfaqësuese të këtyre të fundit në Kuvend.

25. Arsyetimi se edhe jeta parlamentare është e bazuar në partitë politike dhe se grupet parlamentare janë përfaqësuese të vullnetit të partive në Kuvend përforcohet edhe nga formulimi i pikës 1 të nenit 15/1 të Rregullores. Kjo pikë përcakton se: *“Kryetari i grupit parlamentar, brenda një jave nga formimi i grupit, dorëzon një deklaram me shkrim te Kryetari i Kuvendit për pozicionimin politik të grupit parlamentar “pro” ose “kundër” subjektit politik/koalicionit qeverisës, pasi merr miratimin me shkrim të subjektit politik/koalicionit qeverisës.”*. Sipas formulimit të këtij neni të Rregullores Grupi Parlamentar nuk mund të ketë qëndrim politik të ndryshëm nga ai i subjektit (partisë) politik të cilit i përket. Ky rregull dhe kjo varësi shtrihet edhe në të gjithë kohëzgjatjen e ekzistencës së Grupit nga formulimi i pikës 2 të nenit 15/1. Bazuar në këtë nen të Rregullores rezultojnë e qartë varësia hierarkike ndërmjet partisë politike (subjektit politik) dhe Grupit Parlamentar që e përfaqëson atë në Kuvend. Thënë ndryshe qëndrimi politik i grupit parlamentar nuk i nënshtrohet vullnetit të deputetëve, apo vullnetit të shumicës së tyre në Kuvend, dhe as ndonjë forme votimi, por i nënshtrohet vullnetit dhe votimit të organve drejtuese të Partisë Politike / Subjektit Politik nga i cili ky Grup është formuar dhe të cilin përfaqson.
26. Nëse qëndrimi politik i grupit parlamentar do të varej nga vullneti i shumicës së deputetëve përbërës të tij, deputetë të zgjedhur nën siglën dhe platformën e partisë politike, dhe nëse nuk do të ekzistonte një lidhje e qartë varësie ndërmjet Partisë (si struktura komanduese) dhe Grupit Parlamentar (si struktura zbatuese), do të krijoheshin premisat për deformimin e vullnetit të zgjedhësve dhe krijimin e hapësirave për puçe politike dhe institucionale. Mungesa e varësisë do të mund të passillte që një parti politike që ka fituar maxhorancën e votave të votuesve për të qeverisur të mos kishte mundësi të bënte një gjë të tillë për shkak të qëndrimit të ndryshëm të deputetëve në përbërje të grupit të saj, ose ndryshimin e vazhdueshëm të shumicës qeverisëse apo pozicioneve politike të subjektit në varësi të maxhorancës së krijuar në brendësi të grupit parlamentar.
27. Krijimi i shumicave të lëvizshme në Grupin Parlamentar, në mungesë të një varësie të këtij të fundit nga struktura drejtuese e partisë, do të sillte një kufizim të të drejtave të Partisë në parlament dhe një përcudnim të jetës parlamentare. Kjo mundësi mund të arrijë në situatën absurde në të cilën një parti që garon rregullisht në zgjedhje, duke krijuar në këtë formë lidhjen ndërmjet saj dhe zgjedhësve, të jetë në kushtet e pamundësisë (ose mundësisë së kufizuar) për të zhvilluar veprimtarinë intraparlamentare, për të përfaqësuar dhe mbrojtur në rrugë institucionale interesat e mbështetësve (zgjedhësve) të saj. Kjo hapësirë do të ishte e mundur në rast se do të pranohej mundësia e zhvendosjes së autoritetit vendimmarrës nga Partia (si subjekt juridik dhe politik) tek një grumbull (shumicë në grupin parlamentar) deputetësh. Partitë politike, sikurse kemi theksuar më lartë, janë jo vetëm subjektet mbi të cilat është organizuar sistemi zgjedhor në Shqipëri, por edhe ura lidhëse ndërmjet Kuvendit (si pushteti legjislativ) dhe qytetarëve. Pamvarësisht autonomisë që ligji u jep deputetëve, në sistemin aktual zgjedhor (të demokracisë së deleguar) përfaqsimi i qytetarëve në Kuvend nuk i delegohet drejtpërdrejtë deputetit, por subjektit (partisë politike) që e propozon atë, nëpërmjet listës shumëemërore. Në këtë kontekst partia politike është subjekti i përhershëm parlamentar, ndërkohe që deputetët janë përfaqësues të përkohshëm të saj.
28. Është e vërtetë që Rregullorja e Kuvendit i ka dhënë deputetit autonomi dhe mundësi pavarësie në raport me Grupin Parlamentar duke i njohur atij mundësinë e largimit nga Grupi (pika 8 e nenit 15). Por pamvarësisht kësaj pavarësie Rregullorja ka realizuar mbrojtjen e grupeve parlamentare, përbërjes së tyre dhe raportit të forcave të partive politike në parlament duke e kufizuar pavarësinë e deputetit nëpërmjet pamundësisë së bashkimit të këtij të fundit me një

grup tjetër parlamentar. Ky kufizim ka për qëllim ruajtjen e Grupeve Parlamentare (si përçues të politikës zyrtare të partisë që përfaqsojnë dhe në emër të së cilës kanë kandiduar dhe janë zgjedhur si deputetë) e për pasojë të raporteve ndërmjet forcave parlamentare (partive politike dhe votës së marrë prej tyre në zgjedhje) nga qëndrimet individuale të deputetëve. Deputeti është përfaqësuesi, në një zonë të caktuar, i votës së qytetarëve, votë që në sistemin politik shqiptar është marrë si pasojë e pjesmarrjen në zgjedhje në listat e partisë politike. Në këtë këndvështrim deputeti mund të ketë një autonomi të caktuar e cila i nënshtrohet rregullave të partisë në listat e së cilës ai është zgjedhur. Çdo veprim i deputetit në kundërshtim me vendimmarrjen politike të partisë përbën një deformim të vullnetit të zgjedhësve, të cilët votojnë për subjektin politik. Rasti përjashtimor që konfirmon rregullin e parashtruar më lartë është ai i deputetit të pavarur (i zgjedhur nga zgjedhësit sipas nenit 68/1). Parashikimet e nenit 68 që bëjnë dallimin midis deputetit të zgjedhësve dhe deputetit të partisë, konfirmojnë arsyetimin që bartës të vullnetit të publikut dhe interesave të tyre janë partitë politike (për deputetet e zgjedhur nga listat e partive)

29. Nisur nga sa më lartë rezultojnë e qartë se pamvarësisht autonomive të njohura, si deputeti ashtu edhe Grupi Parlamentar janë subjekte që i nënshtrohen vullnetit politik të Partisë të cilën përfaqësojnë, individualisht dhe kolektivisht. Asnjë shumicë në Grupin Parlamentar nuk mund të prodhojë një vendimmarrje në kundërshtim me qëndrimin apo vullnetin e organeve drejtuese të partisë politike. Autonomia e deputetit është e drejta e tij për t'u larguar nga Grupi Parlamentar, në rastin kur ai nuk është dakord me vendimmarrjen politike të Partisë apo vendimmarrjen e Partisë të reflektuar nga Grupi Parlamentar.
30. Sjellim në vëmendjen Tuaj se Grupi Parlamentar quhet "Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike". Ky formulim provon edhe njëherë sa kemi arsyetuar më lartë që Grupi është pjesë përbërë dhe organike e Partisë, pjesë e strukturave të saj statutore dhe se organizimi si dhe funksionimi i tij i nënshtrohet të njëjtave rregulla statutore sikurse të gjitha organet e tjera të Partisë.
31. Neni 16, pika 4 e Rregullores së Kuvendit përcakton detyrimin e Grupeve Parlamentare për miratimin e Rregullores së Brendshme të tyre. Përveç këtij përcaktimi detyrues ligjor, Rregullorja e Kuvendit, nuk ka asnjë dispozitë kontrolluese mbi zbatimin e këtij detyrimi apo efektet që ky detyrim prodhon në raportet e Grupit me Kuvendin. Roli kontrollues i Kuvendit në raport me detyrimet që Rregullorja i cakton Grupit Parlamentar është hallka munguese që tregon se jeta e brendshme e Grupit Parlamentar i nënshtrohet në mënyrë të njëkohshme edhe detyrimit të përcaktuar nga Rregullorja e Kuvendit edhe varësisë hierarkike, të analizuar më lartë, ndaj organeve drejtuese të Partisë. Në këtë detyrim të dyfishtë rregullat partiake kanë përparësi ndaj rregullores së Kuvendit duke patur parasysh karakterin përfaqësues që Grupi ka në raportin ndërmjet Kuvendit dhe Partisë Politike. Duhet theksuar se subjektet juridike në këtë marrëdhënie janë Kuvendi dhe Partia Politike (subjekte që gëzojnë cilësinë e personit juridik dhe si të tillë të përfaqësueshëm juridikisht) dhe se Grupi Parlamentar është vetëm ura lidhëse për funksionimin sa më të thjeshtë të jetës parlamentare, shkak dhe qëllim për të cilin i nënshtrohet edhe rregullimit të dyfishtë të cituar më lartë.
32. Partia Demokratike më datë 02 shtator 2023 ka zhvilluar Kuvendin Kombëtar, i cili ka miratuar ndryshimet në statutin e saj. Ndër këto ndryshime është edhe ndryshimi i drejtimit të Grupit Parlamentar dhe mbulimi i këtij funksioni nga Kryetari i Partisë. Në funksion të ndryshimeve statutore, të hyra në fuqi më datë 03 shtator 2023, dhe të zbatueshme për rregullimin e brendshëm të partisë, nga ana e Kryesisë së Partisë është miratuar Rregullorja e brendshme e funksionimit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike", rregullore me të cilën është

shfuqizuar rregullorja e vitit 2017. Me shkresën e datës 11.09.2023 Kryesia e Kuvendit është vënë në dijeni të ndryshimeve në pozicionin e Kryetarit të Grupit Parlamentar, konform parashikimeve të pikës 2 të nenit 16 të Rregullores.

33. Rregullorja e Kuvendit në rastin e grupeve parlamentare parashikon (në pikën 1 të nenit 16) se grupet parlamentare në mbledhjen e tyre të parë zgjedhin kryesinë e grupit e cila përbëhet nga Kryetari, Nënkryetari/rë, Sekretari dhe Zëdhënësi. Nga formulimi i kësaj pike të Rregullores rezulton e qartë se ky detyrim është i zbatueshëm vetëm në mbledhjen e parë të grupit parlamentar. Pika 2 e nenit 16 përcakton se “Për zgjedhjen e kryesisë, si dhe për çdo ndryshim të mëvonshëm të përbërjes së grupeve, ose kryesive të tyre, vihet në dijeni Kryetari i Kuvendit”. Nga analiza e kësaj dispozite rezulton se pjesa e parë (për zgjedhjen e kryesisë) i referohet qartësisht zbatimit të pikës 1 të nenit 16, pikë e cila është e zbatueshme vetëm në rastin e mbledhjes së parë të grupit parlamentar. Pjesa vazhduese e pikës 2 referon në rend a) ndryshimin e përbërjes së grupit parlamentar dhe b) ndryshimin në kryesinë e grupit parlamentar. Rregullorja nuk përcakton detyrimin për përsëritjen e procesit zgjedhor të parashikuar në rastin e mbledhjes së parë të grupit parlamentar duke e lënë procesin në diskrecionin e funksionimit të partisë politike të cilës i përket grupi parlamentar. Ky qëllim i ligjvënësit konstatohet nga bashkimi në të njëjtën pjesë të fjalisë i dy proceseve krejt të ndryshme siç është ndryshimi i përbërjes së grupit parlamentar (ndryshim i cili mund të vijë për shkaqe krejtësisht të pavarura nga vullneti i grupit apo i mbledhjes së tij) dhe ndryshimi i kryesisë së grupit.
34. Ky qëllim i ligjvënësit rezulton edhe nga roli i cili i është dhënë Kryetarit të Kuvendit në raport me këto ndryshime. Në pikën 2 të nenit 16 është përdorur togfjalëshi “*vë në dijeni*”, togfjalësh i cili i jep Kryetarit të Kuvendit një rol tërësisht pasiv në raport me proceset e brendshme të Grupit Parlamentar. Roli pasiv i Kryetarit të Kuvendit në raport me ndryshimet në Kryesinë e Grupeve Parlamentare është konfirmuar edhe nga praktika më e fundit e ndjekur në raport me Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike deri në shtator të vitit 2023.
35. Nisur nga analiza e mësipërme është e qartë që Kryetari i Kuvendit duhet të pranojë dhe reflektojë me marrjen dijeni çdo ndryshim në Kryesinë e Grupit Parlamentar, përfshirë por pa u kufizuar edhe ndryshimet në pozicionin e Kryetarit të Grupit Parlamentar.
36. Marrja dijeni mund të jetë nëpërmjet aktit të shkruar të Grupit Parlamentar apo të Kryetarit të Partisë. Dëshirojmë të theksojmë se pamvarësisht krijimit të një raporti administrativ ndërmjet Kryetari të Kuvendit dhe Grupit Parlamentar, për shkak të administrimit të jetës parlamentare, Grupi nuk gëzon personalitet juridik dhe veprimtaria e tij në Kuvend është ajo e përfaqësimit të partisë politike. Në këtë këndvështrim komunikimi me personin e autorizuar ligjërisht për të përfaqësuar partinë politike në raport me të tretët (i cili në rastin e Partisë Demokratike është Kryetari i Partisë ose i autorizuari prej tij) prevalon mbi komunikimin me Grupin Parlamentar për shkak të natyrës së varësisë që Grupi Parlamentar ka në raport me strukturat e tjera drejtuese të Partive politike.
37. Për t’u kthyer në analizën e anës objektive të veprës penale vlerësojmë se duhet të ndajmë dhe analizojmë veprimet e shtetases Lindita Nikolla në disa momente të ndryshme kohore.
38. Më datë 04 shtator 2023 Kryetarja e Kuvendit në seancë plenare lexoi (ç’ka në kuptim të praktikës parlamentare merr formën e njoftimit) shkresën numër 138 prot, datë 04.09.2023 të Kryetarit të Partisë Demokratike, njëkohësisht edhe Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë

Demokratike me të cilin njoftohej Kuvendi për ndryshimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar. Shkaku pse ky akt lexohet në seancë plenare (sikurse u lexuar edhe akti i njoftimit të ndryshimit të Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste) është që të gjitha subjektet parlamentare (deputetë apo grupe) të konsiderohen të njoftuara për ndryshimet e drejtuesve apo përbërjes së grupeve parlamentare.

39. Në këndvështrimin ligjor akti i njoftimit publik të deputetëve të Kuvendit, nëpërmjet leximit të shkresës informuese në seancë plenare, ka vlerën e njohjes juridike nga Kuvendi të drejtimit të Grupit Parlamentar nga Kryetari i Partisë Demokratike z. Lulzim Basha. Konsumimi i elementëve të anës objektive të veprës penale nga ana e shtetas Lindita Nikolla fillon pikërisht pas deklarimit të ndryshimit në drejtimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të datës 04.09.2023. Menjëherë pas njoftimit në seancë plenare, Kuvendi, nën drejtimin e shtetas Lindita Nikolla duhet të referonte z. Lulzim Basha si Kryetar të Grupit Parlamentar dhe të pranonte shkresa me efekt juridik mbi të tretët apo me efekt mbi jetën administrative parlamentare të grupit vetëm prej tij. Ndryshe nga ky detyrim ligjor rezulton se Kuvendi, nën drejtimin e shtetas Lindita Nikolla (neni 7 i Rregullores së Kuvendit) ka ndërmarrë veprime administrative dhe ligjore të cilat kanë çenuar interesin e ligjshëm të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, deputetëve dhe anëtarëve të saj. Rezulton se më datë 13.09.2023 shtetasja Lindita Nikolla, në cilësinë e Kryetares së Kuvendit ka nxjerrë urdhrat numër 15 dhe 16 me objekt përfundimin e marrëdhënieve të punësimit me 2 këshilltarë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Marrëdhëniet e punësimit për këshilltarët e grupeve parlamentare lidhen dhe zgjidhen me kërkesë të Kryetarit të Grupit Parlamentar përkatës, ç'ka nënkupton që për vendimmarrjet numër 15 dhe 16, datë 13.09.2023 shtetasja Lindita Nikolla ka vepruar pa një akt shkresor të z. Lulzim Basha në cilësinë e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Zgjidhja e marrëdhënieve të punës me shtetas të cilët e ushtrojnë funksionin e tyre në Kuvend në mbështetje dhe për llogari të Grupit Parlamentar, në mungesë të vullnetit të këtij të fundit (të shprehur shkresërisht nga Kryetari i Grupit) sjellin një cënim të interesit të ligjshëm të Grupit Parlamentar dhe nëpërmjet tij të interesit të ligjshëm të Partisë Demokratike nga njëra anë dhe nga ana tjetër një cënim të interesit të ligjshëm të shtetasve, marrëdhëniet e punësimit të të cilëve me grupin parlamentar janë ndërprerë pa vullnetin e palëve nga Kuvendi. Përpos këtij fakti penal, pranimi dhe zbatimi i kërkesave të depozituara nga deputetë të cilët, në kundërshtim me njoftimet publike në seancë plenare, pranohen nga shtetasja Lindita Nikolla, të ushtrojnë tagrat e Kryetarit të Grupit Parlamentar është cënim i interesit të ligjshëm të subjektit Partia Demokratike.
40. Sjellim në vëmendjen Tuaj faktin që gjatë seancës plenare mbahet procesverbali i seancës, i cili pasqyron deklarimet e të gjitha palëve pjesëmarrëse në seancë përfshi edhe ato të Kryetares së Kuvendit. Procesverbali i seancës miratohet në seancën e ardhshme plenare e më pas publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit. Procesverbali i seancës plenare miratohet me shumicën e votave të deputetëve të parlamentit duke i dhënë në këtë formë vlerën juridike të një akti. Rezulton se procesverbali i seancës plenare të datës 04.09.2023 është miratuar në seancën plenare të datës 11.09.2023 duke i dhënë në këtë formë jo vetëm vlerë juridike deklarimeve të bëra në seancën e datës 04.09.2023, por edhe vlerë detyruese në raport me funksionimin e brendshëm të jetës parlamentare. Në këtë drejtim shtetasja Lindita Nikolla ka kryer veprime në kundërshtim me vendimin e vetë Kuvendit për miratimin e procesverbalit të seancës plenare të datës 04.09.2023, sjelljë që është përsëritur edhe në rastin e procesverbalit të seancës plenare të datës 12.10.2023.
41. Konferenca e Kryetarëve është një nga organizmat e brendshëm të jetës parlamentare. Fusha e kompetencës së Konferencës së Kryetarëve dhe përbërja e saj rregullohet nga neni 12 i

Rregullores së Kuvendit. Neni 12 i Rregullores përcakton se: “1. Konferenca e Kryetarëve diskuton dhe vendos për programin e punës, kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe të komisioneve të tij, si dhe për çështje të zhvillimit të punimeve të Kuvendit në seancë plenare. 2. Konferenca përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët e Kuvendit, kryetarët e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare ose në mungesë të tyre zëvendëskryetarët...”.

42. Nga procesverbalet e mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve rezulton se në mbledhjet e datave 20.09.2023; 29.09.2023 dhe 04.10.2023, nga ana e shtetases Lindita Nikolla, është lejuar të marrë pjesë në cilësinë e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike deputeti Gazment Bardhi, i cili sipas njoftimit publik, në seancë plenare, të vetë shtetases Nikolla, duke filluar nga data 04 shtator 2023 nuk e gëzon më këtë cilësi. Pamvarësisht qëndrimit publik në seancën plenare të datës 04 shtator 2023 të shtetases Lindita Nikolla, dhe korrespondencës së qënësishme shkresore me të cilën Partia Demokratike, nëpërmjet Kryetarit të Grupit Parlamentar të zgjedhur prej saj, ka adresuar aspekte të ndryshme të jetës parlamentare, shtetasja Nikolla ka njoftuar, pranuar dhe lejuar që deputeti Gazment Bardhi të ushtrojë funksionet dhe tagrat që i takojnë deputetit Lulzim Basha duke cënuar në këtë mënyrë interesin e ligjshëm të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë.
43. Në seancën plenare të datës 12.10.2023 Kryetarja e Kuvendit ka njoftuar publikisht njoftimet për përbërjen e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Ndër dy njoftimet e komunikuara publikisht në seancën plenare të datës 12 tetor 2023 rezulton se njëri nga njoftimet lidhet me përfundimin e anëtarësisë së deputetit Gazment Bardhi si pjesë e grupit parlamentar të Partisë Demokratike. Me njoftimin publik të përfundimit të anëtarësisë, në marrëdhëniet me Kuvendin deputeti Bardhi nuk mund të vlerësohet apo konsiderohet pas datës 12 tetor si pjesë apo deputet anëtar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Duke filluar nga data 12 tetor 2023 deputeti Bardhi duhet të konsiderohej nga Kuvendi si deputet jashtë grupeve parlamentare, praktikë e ndjekur (për analogji) me deputetin Sali Berisha. Në kundërshtim me praktikën e mëparshme parlamentare dhe në vijimësi të shkëljes së Rregullores së Kuvendit, të filluara që nga data 4 shtator 2023, Kryetarja e Kuvendit ka vijuar të njohë deputetin Bardhi si Kryetar të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
44. Të njëjtat veprime të shtetases Lindita Nikolla kanë vijuar edhe për mbledhjet e Konferencës së Kryetarëve të datave 01.11.2023; 23.11.2023; 11.01.2024, 24.01.2024 dhe 24.02.2024 në të cilat deputeti Bardhi është thirrur në cilësinë e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, cilësi që nuk e gëzon që nga data 04 shtator 2023 dhe si deputet i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, cilësi të cilën nuk e gëzon nga data 12 tetor 2023.
45. Veprimet e shtetases Nikolla të datës 13.09.2023 (vendimet 15 dhe 16) me të cilat u zgjidhën marrëdhëniet e punës me këshilltarët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, rezultojnë të jenë përsëritur më datë 03.04.2024. Ndonëse në të paktën 3 raste Partia Demokratike i është drejtuar Kryetarës së Kuvendit për lidhjen e marrëdhënieve të punës me shtetas të ndryshëm në cilësinë e këshilltarit dhe sekretares administrative të Grupit, rezulton se asnjë nga këto kërkesa të nënshkruara nga Kryetari i Grupit z. Lulzim Basha nuk është zbatuar nga shtetasja Lindita Nikolla. Përkundrazi, në kundërshtim me detyrimet e përcaktuara nga Rregullorja e Kuvendit dhe njoftimet publike në seancat plenare të datave 04.09.2023 dhe 13.10.2023, shtetasja Nikolla ka vendosur jo vetëm të mos lidhë marrëdhëniet e punësimit sipas kërkesave të Partisë Demokratike, por edhe të zgjidhë marrëdhëniet e punës me këshilltarin Ndriçim Mehmeti, në kundërshtim me vullnetin e Partisë Demokratike, duke cënuar interesat e ligjshëm të këtij subjekti politik.

46. Më datë 09.04.2024 deputeti Bardhi, i është drejtuar shtetases Lindita Nikolla me njoftimin me numër prot 1302, me titull “Mbi përbërjen e grupit parlamentar” me të cilin e njofton për vendimin e grupit për “Revokimin e të gjitha vendimeve për masa disiplinore të marra gjatë kësaj legjislatore” duke kërkuar që të gjithë deputetët të cilët janë deklaruar, në nisje të legjislaturës, si deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të rikthehen në përbërje të këtij grupi. Nga një hulumtim i faqes zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë në internet <https://ëëë.parlament.al/struktura/cb2beaf3-32ee-4f51-85a7-b8645b89617e> rezulton se nga ana e administratës së Kuvendit është reflektuar ndryshimi i kërkuar nga deputeti Bardhi në përbërjen e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Ky veprim i shtetases Lindita Nikolla, në ushtrim të detyrave të saj si Kryetare e Kuvendit çënon në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e ligjshëm të Partisë Demokratike. Duke zbatuar një kërkesë të një deputeti, ndaj të cilit organet më të larta drejtuese të Partisë Demokratike, kanë vendosur largimin nga rradhët e saj Kryetarja e Kuvendit ka çënuar të drejtat e ligjshme politike të subjektit për organizimin e brendshëm të tij dhe si dhe ka çënuar autonominë e vendimmarrjes politike e cila garantohej nga Kushtetuta dhe ligji për partitë politike. Me rikthimin në përbërje të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të deputetëve ndaj të cilëve janë marrë masa të largimit jo vetëm nga grupi por edhe nga anëtarësia në parti, në kundërshtim me vullnetin e Partisë së cilës i përket Grupi Parlamentar, shtetasja Lindita Nikolla ka çënuar interesat e ligjshëm të kësaj të fundit duke i caktuar jo vetëm përbërjen e grupit të saj parlamentar por edhe kryesimin e këtij të fundit. Në asnjë rast Grupi Parlamentar nuk gëzon autonominë (qoftë edhe statutore) për të anashkaluar apo dalë mbi vendimet politike të strukturave drejtuese të Partisë Demokratike. Miratimi i një kërkesë në kundërshtim me vullnetin politik të subjektit, të marrë në përputhje me normat e brendshme statutore është një çënim i drejtpërdrejtë i autonomisë së partisë politike duke sjellë si pasojë ndërhyrjen e një organi shtetëror në jetën dhe organizimin e brendshëm të një entiteti juridik dhe politik jashtë varësisë së tij. Ky çënim është një çënim i drejtpërdrejtë jo vetëm i ligjit për partitë politike por edhe i të drejtës kushtetuese për t’u organizuar në parti politike.
47. Në raport me subjektin e veprës penale vlerësojmë se shtetasja Lindita Nikolla i plotëson kushtet e kërkuara nga ligji për t’u marrë nën përgjegjësi penale. Ajo ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe ushtron një detyrë shtetërore.
48. Në raport me anën subjektive të veprës penale vlerësojmë se nga ana e shtetases Lindita Nikolla veprimet dhe mosveprimet janë kryer me dashje, me qëllim çënimin e interesave të ligjshëm politikë dhe të jetës parlamentare të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë. Me veprimet e saj të pas datës 04 shtator 2023 shtetasja Lindita Nikolla ka çënuar në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike duke mos zbatuar vendimet për kryetarin dhe kryesinë e Grupit, duke shkarkuar dhe zgjidhur marrëdhëniet e punës ndërmjet Grupit dhe këshilltarëve të tij, duke pezulluar për periudhën tetor mars të gjithë veprimtarinë administrative dhe parlamentare të grupit, duke njohur si kryetar të Grupit deputetë të cilët, me vendim të organeve drejtuese të Partisë nuk janë më pjesë e saj. Zbatimi i kërkesave apo njoftimeve të deputetëve të caktuar, të cilët nuk janë pjesë e Partisë Demokratike dhe e Grupit Parlamentar të saj, duke deformuar vullnetin politik të Partisë Demokratike, përbëjnë sjellje me dashje.

BASHKËPUNIMI

49. Forma e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale parashikohet nga neni 25 i Kodit Penal i cili përcakton se: “Bashkëpunim quhet kryerja e veprës penale nga dy ose më shumë persona me marrëveshje ndërmjet tyre”.

50. Nga aktet, rrethanat dhe faktet rezultojnë që deputeti Gazment Bardhi, vecanërisht pas datës 4 shtator 2023 i është drejtuar në mënyrë të vazhdueshme Kuvendit, nëpërmjet njësisë së protokollit, duke protokolluar akte dhe shkresa në ushtrim të tagrave të Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Administrata e Kuvendit, nën drejtimin e Kryetares së Kuvendit, ndonëse në dijeni të faktit që nga ana e Partisë Demokratike ishi depozituar shkresa dhe akte për ndryshimin e kryetarit të Grupit Parlamentar, ndryshim që ishte njoftuar publikisht edhe në seancë plenare, ka vijuar të pranohë shkresa adresuar Kryetares së Kuvendit nga deputeti Gazment Bardhi në cilësinë e Kryetarit të Grupit Parlamentar. Këto shkresa jo vetëm që janë pranuar, por pas pranimit janë cikluar nga kryetarja e Kuvendit dhe janë zbatuar nga pjesa tjetër e administratës së Kuvendit.
51. Vlen të sjellim në vëmendjen Tuaj faktin e relatuar edhe më lartë në këtë kallzim të varësisë hierarkike të Grupit Parlamentar nga Partia dhe të funksionit përfaqësues të këtij të fundit ndërmjet Partisë dhe Kuvendit. Në këtë kontekst duhet t'i referohemi ligjit për partitë politike i cili përcakton se në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Tiranës shënohet emri i personit që tagrat e përfaqësimit ndaj të tretëve. Në rastin e Partisë Demokratike personi që gëzon tagrat e përfaqësimit ndaj të tretëve është Kryetari i Partisë, i cili me ndryshimet statutore të hyra në fuqi me datë 3 shtator është edhe Kryetar i Grupit Parlamentar.
52. Duke filluar nga data 04 shtator, me leximin publik nga Kryetarja e Kuvendit të ndryshimit të kryesimit të Grupit Parlamentar, të gjitha tagrat që i ishin deleguar deputetit Bardhi nga Partia Demokratike në cilësinë e drejtuesit të grupit parlamentar të saj konsiderohen të revokuara. Në mungesë të këtyre tagrave, apo të një akti delegues të tagrave të Kryetarit të Grupit Parlamentar administrata e Kuvendit, dhe vecanërisht Kryetarja e Kuvendit, nuk mund të lejonin që në protokollin e Kuvendit të regjistroheshin akte shkresore në të cilat deputeti Bardhi të reflektohej si Kryetar i Grupit Parlamentar dhe aq me pak që këto akte të përcilleshin për zbatim nga Kryetarja e Kuvendit tek strukturat në varësi të saj.
53. I njëjti fenomen përsëritet edhe pas seancës plenare të datës 12 tetor në të cilën, ndryshe nga seanca plenare e datës 04 shtator deputeti Bardhi u nxorr jashtë listës së deputetëve që përbëjnë Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike. Pas kësaj seance deputeti Bardhi jo vetëm që nuk mund të identifikohet më nga administrata e Kuvendit si Kryetar por nuk mund të identifikohet as si deputet i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.
54. Në kundërshtim me qëndrimin zyrtar të Partisë Demokratike, të bërë publik nga Kryetarja e Kuvendit, kjo e fundit dhe administrata e Kuvendit, në bashkëpunim me njëra tjetrën kanë lejuar që në protokollin e Kuvendit të administrohen akte shkresore të lëshuara nga një deputet që nuk gëzonte tagrat e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, që këto akte të shpërndahen në administratën e Kuvendit dhe që kjo e fundit nën urdhërimin e Kryetares së Kuvendit të kryente dhe zbatimin e kërkesave që prodhonin efekte ligjore tek të tretët (duke marrë si shembull këshilltarët e grupit parlamentar të cilëve i'u ndërpreu marrëdhëniet e punës).

KONKLUZIONE

55. Në përfundim vlerësojmë se nga ana e shtetasës Lindita Nikolla janë konsumuar plotësisht elementët e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës" të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal.

56. Për të mbështetur arsyetimet e parashtruara në këtë kallëzim po ju bashkëlidhim provat si më poshtë vijon:

- Shkresa numër 138 prot, datë 04.09.2023, drejtuar Kryetares së Kuvendit;
- Shkresa numër 137 prot, datë 03.09.2023 “Vendim numër 24, datë 03.09.2023”;
- Shkresa numër 148 prot, datë 13.09.2023, “Njoftim” drejtuar Kuvendit të Shqipërisë;
- Shkresë numër 2583/5 prot, datë 13.09.2023 “Për lirim nga detyra”;
- Shkresë numër 2583/6 prot, datë 13.09.2023 “Për lirim nga detyra”;
- Shkresa numër 155 prot, datë 13.09.2023, “Njoftim” drejtuar Kuvendit të Shqipërisë;
- Shkresa numër 164 prot, datë 26.09.2023, “Njoftim mbi përbërjen e Grupit Parlamentar” drejtuar Kuvendit të Shqipërisë;
- Shkresa numër 177 prot, datë 10.10.2023, “Njoftim mbi përbërjen e Grupit Parlamentar” drejtuar Kuvendit të Shqipërisë;
- Shkresa numër 178 prot, datë 11.10.2023, “Njoftim” drejtuar Kuvendit të Shqipërisë;
- Shkresa numër 179 prot, datë 12.10.2023, “Njoftim” drejtuar Kuvendit të Shqipërisë;
- Shkresa numër 180 prot, datë 12.10.2023, “Njoftim” drejtuar Kuvendit të Shqipërisë;
- Shkresa numër 186 prot, datë 27.10.2023, “Njoftim” drejtuar Kuvendit të Shqipërisë;
- Shkresa numër 194 prot, datë 27.10.2023, “Njoftim” drejtuar Kuvendit të Shqipërisë;
- Shkresë numër 3242/3, datë 03.04.2023 “Për lirim nga detyra”;
- Procesverbal i Seancës plenare të Kuvendit datë 04.09.2023;
- Procesverbal i Seancës plenare të Kuvendit datë 13.10.2023;
- Procesverbal i Konferencës së Kryetarëve datë 20.09.2023;
- Procesverbal i Konferencës së Kryetarëve datë 29.09.2023;
- Procesverbal i Konferencës së Kryetarëve datë 04.10.2023;
- Procesverbal i Konferencës së Kryetarëve datë 01.11.2023;
- Procesverbal i Konferencës së Kryetarëve datë 23.11.2023;
- Procesverbal i Konferencës së Kryetarëve datë 11.01.2024;
- Procesverbal i Konferencës së Kryetarëve datë 24.01.2024;
- Procesverbal i Konferencës së Kryetarëve datë 24.02.2024;

PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË

Përfaqësuar nga

ENKELLEJDS ALIBEA

